



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OMK), përmes Komisionit për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, duke u mbështetur në dispozitat e Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional, përkatësisht në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe nenin 20, paragrafi 2, lidhur me subvencionimin e aktiviteteve të veçanta të edukimit të vazhdueshëm profesional, më datë 22.12.2025, shpall:

KONKURS PUBLIK PËR PËRKRAHJEN FINANCIARE TË AKTIVITETEVE TË VEÇANTA TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL - EVP

Hyrje

OMK përmes organeve të saj, respektivisht Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional, me qëllim të përkrahjes së zgjerimit dhe avansimit të edukimit të vazhdueshëm profesional, do të përkrahë financiarisht aktivitete, organizime dhe edukim profesional të cilat organizohen nga shoqatat profesionale dhe institucione publike shëndetësore. Kjo përkrahje financiare do të realizohet sipas procedurës së konkurimit të shoqatave profesionale dhe institucioneve shëndetësore nga buxheti i OMK-së.

Subjektet e autorizuar për përkrahje financiare dhe kriteret për aplikim

Subjektet e autorizuar sipas kësaj rregulloreje, siç janë shoqatat profesionale, do të përkrahen për organizime të veçanta të edukimit të vazhdueshëm profesional, nën kushtet e përgjithshme dhe kushteve të veçanta që janë të përcaktuara me Rregulloren e KEVP, si në vijim:

Kushtet e përgjithshme si në vijim:

- Aktin e regjistrimit të shoqatës me të cilën dëshmohet se shoqata është e regjistruar me status të organizatës joqeveritare sipas legjislacionit në fuqi;
- Dëshmia për qëndrueshmërinë financiare;

- Deklarata e funksionalitetit - e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqatës dhe anëtarët e bordit drejtues të shoqatës me të cilën bëhet deklarimi i funksionalitetit të shoqatës;
- Dëshmia se shoqatës nuk i është revokuar certifikata e aktivitetit apo programit të EVP-së në tre (3) vitet e fundit.

Kushtet e veçanta si në vijim:

- Elaborati profesional/shkencor me të cilin do të përshkruhet përmbajtja e aktivitetit të EVP-së;
- Lista e ligjëruesve dhe prezantimet me dokumentacionin përcjellës të ligjëruesve duke përfshirë CV-të të ligjëruesve në event; dhe
- Dokumenti i përshkrimit të impaktit të aktivitetit nga aspekti praktik dhe multidisiplinar;

Informacione të tjera:

- Konkursi publik do të jetë i hapur në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e publikimit të tij;
- Aktiviteti për të cilin bëhet aplikimi duhet të mbahet jo më vonë se muaji i 11-të i vitit kalendarik në të cilin aplikohet;
- Aktivitetet të mos përmbajnë kuotizim për anëtarët e Odës;
- Dokumentacioni sipas kriterëve të lartëcekura duhet të dorëzohet në ekzemplar fizik dhe në dokumente origjinale apo të noterizuara.
- Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyret e OMK-së, me adresë: QKUK, INSTITUTI A, KATI I III-TË, 10 000 – PRISHTINË RKS. Personi kontaktues: Gëzim Fazliu, nr. kontaktues 049/872-070.
- Afati i fundit për aplikim, pas shtyrjes përfundon më 4 Shkurt 2026, ora 16:00.
- Për çdo informatë shtesë luteni të kontaktoni në email adresën zyrtare të Odës info@omk-rks.org dhe numrin e telefonit 049/872 070